

VENDIM
Nr.63, datë 14.9.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar; dhe të nenit 59, pika 3 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin nr.58, datë 5.5.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja “a” ndryshon si më poshtë:

“...vlera e kredisë në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë për kredimarrësin që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4, pika 2, shkronja “c” të rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë” dhe karakteristikat e përcaktuara në pikën 8.1.4 shkronja “f”, të kësaj rregulloreje...”

b) Neni 8, pika 8.1.5, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“...vlera e kredisë së akorduar jashtë territorit ku banka ushtron veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj...”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani